



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 38

Tiranë – E hënë, 30 tetor 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 4288, datë 24.10.2023	Për rishpalljen e 1 (një) vendi vakant për pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.....	3
Njoftim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 81/5, datë 26.10.2023	Për bankat e nivelit të dytë, për të paraqitur oferta për normën e interesit të kredisë studentore.....	3

**NJOFTIM****Nr. 4288, datë 24.10.2023****PËR RISHPALLJEN E 1 (NJË) VENDI
VAKANT PËR POZICIONIN E
KËSHILLTARIT LIGJOR NË
KOMISIONIN E PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT**

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ligjor, me kategorinë e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master shkencor”, në Shqipëri, ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe të ketë marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) Të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit nr. 188, datë 4.3.2015, të Këshillit të Ministrave;

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal dhe të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur dhe për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

- Kopje të dokumenteve: diplomë, letërnjoftim dhe librezë pune (origjinale ose të noterizuara);

- Dëshmi penaliteti;

- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen **brenda datës 23 nëntor 2023**, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-godina e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna-të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, që konfirmon marrjen e aplikimit përkatës

NJOFTIM**Nr. 81/5, datë 26.10.2023****PËR BANKAT E NIVELIT TË DYTË,
PËR TË PARAQITUR OFERTA PËR
NORMËN E INTERESIT TË KREDISË
STUDENTORE**

Në mbështetje të nenit 11, pika 1/c, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të germës “c”, të pikës 3, të VKM-së nr. 397, datë 3.5.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë”; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 19.7.2023, “Për përcaktimin e skemës së Kreditimit Studentor”,

Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) fton Bankat e Nivelit të Dytë të interesuara, të paraqesin ofertë për normën e interesit për kreditin studentor, sipas kushteve të skemës së kreditimit studentor, të përcaktuara në VKM-në nr. 440, datë 19.7.2023.

Sipas skemës së kreditimit studentor, studentët të cilët plotësojnë kushtet kanë të drejtë të përfitojnë kredi studentore për financimin e kostos së studimeve, ku një pjesë e normës së interesit të kredisë (jo më shumë se pesë pikë përqindje) do të financohet nga buxheti i shtetit.

Kreditimi i studentëve do të realizohet nga një bankë e nivelit të dytë, e cila do të përzgjidhet me procedurë konkurrimi. Procedurat, rregullat e përzgjedhjes dhe të renditjes së Bankave të Nivelit të dytë, si dhe procedurat e ankimit, përcaktohen



në urdhrin përkatës të drejtorit të përgjithshëm të AKFAL-it, sipas dokumenteve bashkëlidhur kësaj shpallje. Të gjitha Bankat e Nivelit të Dytë për t'u kualifikuar duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

Renditja e ofertave të bankave do të bëhet nga komisioni i vlerësimit dhe i renditjes, që ngrihet nga AKFAL-i, i cili do të rendisë ofertat e administruara, sipas normës më të ulët të interesit.

Për sa më sipër:

Ftojme çdo bankë të nivelit të dytë të paraqesë ofertën e saj, dorazi ose me postë, të mbyllur në zarf, të specifikuar për protokollin me shënimin: *“të mos hapet deri në datën e caktuar”*, brenda 60 ditëve kalendarike nga momenti i publikimit të thirrjes në

Buletin e Njoftimeve Zyrtare, në adresë të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, *adresa: Rruga “Naim Frashëri”, nr. 37, Tiranë.*

Dokumentet bashkëngjitur ofertës duhet të dorëzohen të noterizuara, sipas anekseve më poshtë:

- Aneksi 1: Lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim;
- Aneksi 2: Formulari tip i aplikimit;
- Aneksi 3: Deklarata për pranimin e kushteve të përcaktuara në VKM-në nr. 440/2023;
- Aneksi 4: Formulari tip i deklarimit të konfliktit të interesit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Artan Spahiu

ANEKS 1

LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM

Përbën shkak skualifikimi, mungesa e dokumentacionit, sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta.

Kritere të përgjithshme të kualifikimit
1. Dokumentin e licencimit për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë nga Banka e Shqipërisë (bashkëngjitur, kopje e noterizuar).
2. Ekstrakti nga Qendra Kombëtare e Biznesit (bashkëngjitur, kopje e noterizuar).
3. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore për vitin 2023 (bashkëngjitur, kopje e noterizuar).
Kritere të veçanta të kualifikimit
1. Deklarata për dakordësinë mbi kushtet e parashikuara në VKM-në nr. 440/2023, sipas aneksit 3.

Bankat e nivelit të dytë duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas thirrjes publike.

Në rast të mosplotësimit të një prej kriterëve, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë nuk kualifikohet.

E drejta e ankimit mund të ushtrohet nga Bankat e Nivelit të Dytë, brenda 5 (pesë) ditëve, nga data e njoftimit dhe e shpalljes së renditjes nga Komisioni i Vlerësimit dhe Renditjes, në rrugë postare pranë AKFAL-it.



ANEKSI 2
FORMULARI TIP PËR APLIKIMIN E BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË BANKËS SË NIVELIT TË DYTË		
PËRFAQËSUESI LIGJOR: _____		
Numri identifikimit personal të përfaqësuesit (sipas kartës së identitetit/pasaportës): _____		
Banka e Nivelit të Dytë _____	NIPT _____	Akti i licencimit Nr. _____, datë _____._____._____
Adresa e selisë:		
Propozimi i normës së interesit për kredinë studentore:		
Norma e interesit e propozuar: _____ (_____)%		
Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Autorizoj MAS-in dhe/ose AKFAL-in për trajtimin e të dhënave të mia personale, në kuadër të aplikimit tim. KËRKUESI _____ <i>emri, mbiemri, nënshkrimi, vula</i> E-mail: _____ Nr. cel: _____		

ANEKSI 3
DEKLARATË PËR PRANIMIN E KUSHTEVE TË PËRCAKTUARA NË
VKM-në NR. 440/2023

Deklaruesi: _____

Unë _____, në pozicionin _____ dhe përfaqësues ligjor i Bankës së Nivelit të Dytë _____, deklaroj se Banka është dakord dhe pranon të jetë pjesë e skemës së kreditimit studentor, duke plotësuar kushtet e parashikuara në VKM-në nr. 440/2023, për kontratën Bankë-Student, e konkretisht:

- kredia studentore do të jepet pa kolateral fizik;
- kredia studentore do të jepet për mbulimin e kostove vetëm për ndjekjen e një programi studimi;
- financimi i kredisë do të bëhet me këste, të paktën dy herë në vit, dhe financimi i çdo kësti realizohet vetëm pas konfirmimit nga institucioni i arsimit të lartë, që studenti kredimarrës ka shlyer tarifën vjetore të shkollimit të vitit akademik dhe ka frekuentuar procesin mësimor;
- detyrimi i shlyerjes së kredisë, përfshirë principalin dhe interesin e kredisë nga studenti kredimarrës, do të fillojë jo më herët se 3 (tre) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të parë; jo më herët se 2 (dy) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të dytë dhe jo më herët se 5 (pesë) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të integruar të ciklit të dytë;
- norma e interesit të kredisë studentore e propozuar nga Banka jonë është më e ulët se norma mesatare e interesit për kredi konsumatore, të dhëna nga institucioni ynë për 2 (dy) vjetet e fundit, përfshirë vitin në të cilin jepet kjo kredi;
- norma e interesit të kredisë së propozuar do të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së kredisë.

Nënshkrimi _____

emri, mbiemri, nënshkrimi, vula



ANEKSI 4
FORMULARI I DEKLARIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaruesi: _____

Unë, _____, në pozicionin e _____ dhe të përfaqësuesit ligjor të Bankës së Nivelit të Dytë _____, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit, që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi, që mund të cenojë zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes së aplikimeve për financimin e normës së interesit.

Kjo deklaratë është hartuar më datë _____._____.2023.

Nënshkrimi _____
emri, mbiemri, nënshkrimi, vula

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2023